

## PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Kjo Strategji e Partneritetit për Vendin (SPV) për Shqipërinë, e përgatitur nga Grupi i Bankës Botërore (WBG), mbulon periudhën VF11-VF14 dhe është e para SPV që do t'i prezantohet Bordit që prej graduimit të Shqipërisë nga IDA (Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim) në mesin e vitit 2008. SPV është në linjë të plotë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), e cila është përgatitur nga Qeveria në kuadër të një procesi me pjesëmarrje të gjerë që përfshinte palët e interesuara në të gjithë vendin. Programi i SPV gjithashtu merr parasysh eksperiencën e përfutur prej zbatimit të strategjisë së fundit për vendin, gjetjet e raporteve analitike të Bankës dhe nga aktivitetet e donatorëve të tjerë.

Shqipëria ka qenë ***një histori zhvillimi e suksesshme*** në shumë aspekte. Gjatë dy dekadave të fundit vendi ka bërë hapa gjigandë në vendosjen e një demokracie të besueshme shumëpartiake dhe të ekonomisë së tregut, si dhe po riintegrohet me shpejtësi në komunitetin ndërkombëtar dhe europian. Për më shumë, gjatë dekadës së fundit, Shqipëria ka qenë një nga vendet me nivelin më të shpejtë të rritjes ekonomike në Evropë, duke gëzuar rritje vjetore mesatare reale prej 6%, e shoqëruar kjo me ulje të shpejtë të varfërisë. Niveli i Varfërisë është zvogëluar dy herë (në rreth 12.4 përqind) midis viteve 2002 dhe 2008, ndërkohë që varfëria ekstreme tashmë prek vetëm 2 përqind të popullsisë. Për më tepër, vendi ka kryer një progres të qëndrueshëm drejt arritjes së Objektivave për Zhvillim të Mijëvjeçarit (OZHM), edhe pse treguesit socialë mbeten pas në nivel të konsiderueshëm nga BE10 dhe Kroacia.

Shqipëria është një nga të paktët vende në Evropë që mundi të rruante një rritje pozitive ekonomike - edhe pse me reduktim të konsiderueshëm dhe stabilitet financiar gjatë vitit 2009, paqja krizës globale financiare dhe ekonomike. Deri më tani, ndikimi i krizës është ndjerë kryesisht në zvogëlimin e nivelit të remitanacave dhe tregtisë. Një ekspansion substancial fiskal gjatë vitit 2008 dhe 2009 gjithashtu ndihmoi në zbutjen e impaktit të krizës, por që duhet që të tërhiqet në mënyrë të shpejtë. Duke marrë parasysh ringritjen e ngadaltë në Evropë, perspektiva e Shqipërisë për rritje mund të jetë më pak e favorshme se në të shkuarën. ***Sfidat kryesore për të ardhmen*** janë të paraqitura më poshtë: (i) rifillim i shpejtë i procesit të konsolidimit financiar dhe forcimit të menaxhimit të shpenzimeve publike; (ii) reforma rregullatore dhe institucionale për të forcuar konkurrueshmërinë dhe investimet; (iii) përmirësimi i nivelit arsimor dhe aftësive për t'u përballur me kërkesën e biznesit; (iv) reduktim i deficiteve në infrastrukturë në mënyrë të qëndrueshme nga ana fiskale; dhe (v) përmirësimin e efektivitetit të sistemeve të mbrojtjes sociale dhe shërbimeve mjekësore kryesore në mënyrë që të mënjanohej rreziqet e reja që mund të lindin si pasojë e një ringritje të ngadaltë. Për më tepër, duke qenë se Shqipëria është vulnerabël ndaj ndryshimeve klimatike (si pasojë e vartësisë së lartë ndaj ujit për prodhim energjie dhe vaditjen në sektorin bujqësor - me rëndësi të veçantë ekonomike) është thelbësore që vendi të marrë hapa të shpejtë për të përshtatur në mënyrën e duhur infrastrukturën e tij ujore dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimaterike.

SPV e përbashkët e Grupit të Bankës do ta ndihmojë Shqipërinë për t'u përballur me sfidat e sipër përmendura, duke u fokusuar në tre objektiva strategjik:

- ***Mbështetje në ngritjen e nivelit të rritjes ekonomike të Shqipërisë përmes përmirësimit të kushteve të konkurrueshmërisë***, duke forcuar menaxhimin makroekonomik dhe atë të shpenzimeve publike, duke përmirësuar klimën e biznesit, duke adresuar kur të mund pengesat infrastrukturore, dhe duke thelluar aksesin ndaj kredive
- ***Duke zgjeruar dhe mbështetur përfitimet sociale*** përmes përmirësimit të shërbimeve arsimore dhe shëndetësore dhe duke vendosur masa të përshtatshme sigurie
- ***Të reduktojë vulnerabilitetin ndaj ndryshimeve klimatike*** duke përmirësuar konservimin dhe menaxhimin e ujit dhe duke ngritur nivelin e përgatitjes për katastrofat.

*Nën këtë SPV, qasja e Grupit të Bankes Boterore synon drejt një programi më të fokusuar e sinergjik, me përfshirje të koordinuar të IBRD-IFC në sektorët e mëposhtëm me prioritet: (i) infrastrukturë kombëtare-energji dhe rrugë; (ii) infrastrukturë në nivel lokal, kryesisht menaxhimi i furnizimit me ujë dhe menaxhimi i mbeturinave; dhe (iii) mjedisi i biznesit. Për më tepër, programi SPV reflekton një fokus të thelluar nënrajonat në Ballkanin Perëndimor dhe në Evropën Juglindore veçanërisht në energji, tregti/transport dhe menaxhimin e katastrofave.*

*Programi SPV do të vazhdojë që gjithashtu të mbështesë përmirësimet në qeverisjen e Shqipërisë përmes përdorimit të një “filtri për qeverisjen” për të gjithë veprimtaritë e financuara nga Banka në mënyrë që të promovojë menaxhimin, eficientën dhe përmirësimet në transparencën ndërmjet ministrive.*

Një fokus kryesor i përpjekjes së Bankës përmes kësaj SPV do të jetë dhe përqendrimi tek *përmirësimi i zbatimit të portofolit të madh ekzistues* për projektet e financuara nga Banka në Shqipëri (të cilat janë në përputhje të plotë me sfidat e zhvillimit që përshkruhen më poshtë). *Projektet e reja do të shtohen në mënyrë shumë selektive*, dhe vetëm në një numër të vogël të fushave kyç. Fokusi ndaj portofolit ekzistues është i nevojshëm në mënyrë që të shihen ndikimet e pritura të zhvillimit ndërkohë që përmirësohet ritmi i transferimit të resurseve tek Qeveria ndërsa përballet me vështirësi të reja fiskale. Një qëllim kyç do të jetë integrimi i mëtejshëm i veprimtarive të financuara nga Banka në buxhetin Qeveritar dhe kuadrin administrativ për të arritur përfitime në shkallë të gjerë në menaxhimin e shpenzimeve publike dhe transparencë. Strategjia e huadhënies për më pak projekte, por për projekte më të mëdha, i përgjigjet kërkesës eksplicite të Qeverisë në këtë aspekt si dhe gjithashtu lejon përfundimin e konsolidimit të portofolit të investimeve me 10-12 veprimtari për VF14 (nga 21 projekte në VF04). Kjo iniciativë nga anë e saj, do të mundësojë më shumë kohë për resurset e brendshme të Bankës për t'u marrë me punë më analitike dhe këshillimore për sfidat e ardhme të Qeverisë së Shqipërisë

*Huat e ardhshme të BNRZH* për Shqipërinë gjatë periudhës së SPV priten të arrijnë shumën e rreth 275 milion\$ ndërkohë që *IFC pritet të rrisë financimet e saj* për sektorin privat me rreth 120-150 milion \$. Nga totali i huave të BNRZH, i cili do të jetë pjesë e kapacitetit financiar të BNRZH, vetëm mbi 35 përqind (apo 100 milion\$) mund të mundësohen në formën e mbështetjes buxhetore me shpërndarje të shpejtë bazuar në politika, duke marrë parasysh një kuadër të kënaqshëm makroekonomik. Mbështetja vjetore për buxhetin ka gjasa të jetë në shumën 25 milion \$, fillimisht për projekte me karakter reformues të sektorit social dhe më pas për një seri prej tre DPL (Huadhëniesh sipas Politikave për Zhvillim) të fokusuara në rritje ekonomike dhe investime. Duke qenë e re, mbështetja e BNRZH do të mundësohet në formën e 8 veprimtarive investuese për sektorët social, menaxhimin e resurseve natyrorë, infrastrukturë, dhe reformën në sektorin publik. Investimet e IFC do të kanalizohen përmes financimit direkt në sektorë kyç si agro-biznesi, energjia dhe sektorët socialë. Investimet në sektorin financiar do të forcojnë kapitalizimin e bankave (aty ku është e nevojshme) dhe do të mundësojë financim afatgjatë për sipërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (MSMEs), energjinë e rinovueshme dhe produktet me efikasitet energjetik. IFC gjithashtu do të përdorë shërbimet e saj këshillimore për të siguruar financim privat përmes PPPve për mirëmbajtjen e rrugëve, furnizimit me ujë, menaxhimin e mbeturinave dhe energjinë e rinovueshme.

Zbatimi i SPV është subjekt i *i katër rreziqeve kryesorë*. Së pari, *vonesat në zbatimin e një përshtatje fiskale apo thellimi i krizës në Eurozonë mund të rrezikojë stabilitetin makroekonomik* duke ndikuar kështu programin e planifikuar për mbështetjen buxhetore. Për të akomoduar të tillë rreziqe, programi i SPV është planifikuar që të jetë fleksibel- duke mundësuar zvogëlim të huave me disbursim të shpejtë në rastin e zgjerimit të vazhdueshëm fiskal apo, në rast të kundërt, një rritje substanciale të mbështetjes buxhetore nëse Shqipëria goditet nga faktor të huaj paçka politikave të shëndosha makroekonomike. Së dyti, *klima e polarizuar politike në Shqipëri mund të shkaktojë ngërçe në*

*vendosjen e politikave dhe/apo ngërçe institucionale.* Ndërkohë që është e vështirë që të adresohet plotësisht ky rrezik, shpresohet se konsensusi midis partive sipas axhendën së aderimit të Bashkimit Evropian (BE) do të mundësoj progres në këtë aspekt. Së treti, duke pasur parasysh se huat e reja të BNRZH janë relativisht të vogla dhe në mënyrë të përshkallëzuar më selektive, është e mundur që ***aftësia e Bankës për të ndikuar reformat sektoriale përmes dialogut mbi politikat dhe zhvillimin institucional mund të zvogëlohet*** – veçanërisht ndërkohë që financimi koncesionar nga BE bëhet më i gjindshëm. Gjithsesi, kjo nevojë nuk ndikon domosdoshmërisht në rezultatet në terren duke qenë se Grupi i Bankës do të vazhdojë të mundësojë shërbime analitike dhe këshillimore për të ndihmuar që Shqipëria të përballet me sfidat e saj për Zhvillim. Për më tepër, Banka do të vazhdojë partneritetin e ngushtë me BE për shumë programe me rëndësi për zhvillimin në Shqipëri. Së fundmi, ***performanca e portofolit mund të ndikohet nga shtrëngesa të vazhdueshme në kapacitetin zbatues të Qeverisë***, edhe pse këto shqetësime po adresohen përmes ndërtimit të kapaciteteve dhe konsolidimit e programit të Bankës.